



AGJENCIA SHYTËRORE E KADASTRËS

INDIKATORËT E PERFORMANCËS

(2006 - 2022)



Tiranë, 31.01.2023

Hyrie

Prej vitit 2020, ASHK ka filluar të përgatisë çdo fund viti një material që përmbledh **disa prej indikatorëve kryesorë të performancës** së institucionit. Kjo me qëllim që të evidentohen ndryshimet e sjella përmes këtij procesi, qoftë pozitive dhe qoftë negative.

- **Për fushën e veprimtarisë së ish-ZRPP**, indikatorët marrin në evidencë kryesisht periudhën 2015-2021, pasi vetëm për këtë periudhë mund të nxirren të dhëna përmes sistemit të trashëguar nga ish-ZRPP. Sdq, do thënë që të dhënat e trashëguara janë shumë fragmentare dhe të pasigurta, pasi në shumicën e rasteve ato ose nuk mblidheshin, ose mblidheshin me telefon.

- **Për fushën e veprimtarisë së ish-ALUIZNI-t**, të dhënat përfshijnë periudhën që nga viti 2006, pasi janë ekzistuese edhe të dhënat për atë periudhë.

- **Për fushën e veprimtarisë së AMTP-ve**, të dhënat janë shumë fragmentare, pasi në asnjë kohë nuk ka pasur të dhëna statistikore të besueshme, të qëndrueshme dhe të vazhdueshme as nga ish ZRPP dhe as nga Ministria e Bujqësisë.

Përgjithësisht janë zgjedhur **indikatorë që janë matur dhe të matshëm ndër vite**, për të pasur besueshmëri të procesit krahasimor.

Në këtë material, paraqiten kryesisht **indikatorë krahasimorë dhe jo thjesht sasiore**, pasi vetëm të parët japin informacion rreth rezultatit të punës së institucionit.

Ky material do të vijojë të plotësohet vit pas viti duke shtuar edhe indikatorë të rinj, si p.sh. procesi i regjistrimit të pronës shtetërore, proces ky i lënë tërësisht pas dore për vite të tëra, etj.

Për vitin 2021, disa prej **indikatorëve u ndikuan negativisht nga dy faktorë:**

- Covid-19. Virusi ngadalësoi në mënyrë të dukshme dhënien e shërbimeve, përfshiu një pjesë të punonjësve, etj.

- Problemet me sistemin dhe mbingarkimin e tij.

Për vitin 2022, praktikisht të gjitha sistemet kanë hyrë në funksionim normal, duke bërë që edhe institucioni në përgjithësi të ketë vazhdueshmëri pune standarde.

INDIKATORËT HISTORIKË TË PERFORMANCËS (2006-2022)

I. SHËRBIMET KADASTRALE

- 1 - Numri i shërbimeve kadastrale në vite.**
- 2 - Koha mesatare e dhënies së shërbimit.**
- 3 - Aplikime pa përgjigje.**
- 4 - Aplikimet për shërbime kadastrale.**
- 5 - Numri i Certifikatave të pronësisë.**
- 6 - Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme.**
- 7 - Nafta për Fermerët.**
- 8 - Regjistrimi i AMTP-ve.**

II. PROCEDURA ADMINISTRATIVE E LEGALIZIMIT

- 9 - Legalizimet.**
- 10 - Përrjashtimi nga legalizimi i ndërtimeve pa leje.**
- 11 - Legalizimi i pallateve të braktisura nga ndërtuesit.**
- 12 - Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991.**
- 13 - Kompensimi i pronarëve të truallit të zënë nga ndërtimet pa leje.**

III. PROCESI I PËRMIRËSIMIT HARTOGRAFIK

- 14 - Përmirësim / Përditësimi i blloqeve kadastrale.**
- 15 - Regjistrimi fillestar.**
- 16 - Ligjërimi dhe përfshirja e pasurive në bazën e të dhënave (ALBSCAD).**
- 17 - Qendra e Kadastrës Digjitale.**

IV. AKTET NËNLIGJORE

- 18 - Ecuria e akteve nënligjore.**

V. SITUATA FINANCIARE

- 19 - Të ardhurat / shpenzimet.**
- 20 - Sistemi i zyrave.**

VI. ANKIMET

- 21 - Proceset gjyqësore.**
- 22 - Apelimi.**
- 23 - Portali i Bashkëqeverisjes.**

VII. TË TJERA

- 24 – Problematika.**
- 25 - Risitë e Vitit 2022.**
- 26 - Synimet për vitin 2023.**

I. SHËRBIMET KADASTRALE




1. Numri i shërbimeve kadastrale në vite.

Aktualisht **ASHK realizon online të gjitha shërbimet nga regjistri kadastral.** Reforma digjitale në shërbimet mundësoi kthimin e të gjithë punës aktuale të kadastrës në sistem, që nga fillimi i vitit 2020 (Urdhri i KM Nr.153 datë 25.11.2019). Kryerja e të gjithë aplikimeve vetëm online nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania si dhe sistemeve të tjera si Dhoma Kombëtare e Noterisë, etj., solli eliminimin e radhëve nëpër sportele, si dhe rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve kundrejt Qytetarëve, duke ulur ndjeshëm kohën e marrjes së përgjigjes.

Llojet e shërbimeve që ofron ASHK janë përcaktuar me akt nënligjor (VKM) dhe përfshijnë 76 shërbime të ndryshme.

Gjithsesi, volumi i punës shpreh trendin e përgjithshëm të nevojave të popullsisë dhe aftësinë përgjigjëse të Institucionit. Në numrin e shërbimeve kadastrale nuk përfshihen numri i përgjigjeve të kthyer për plotësim dokumentacioni (ose ndryshe AV).

Viti	Nr. Shërbime:
2018	735,232
2019	765,223
2020	883,875
2021	1,514,985
2022	1,227,334



Koment: Me mbylljen e vitit 2022, konstatohet një trend zbritës i numrit të shërbimeve ndaj qytetarëve, në krahasim me vitin e kaluar, konkretisht 19% më i ulët.

Ulja e numrit të shërbimeve kadastrale gjatë vitit 2022 lidhet me dy faktorë:

- Në fund të muajit prill 2022, u mbyll procesi i rivlerësimit të pasurive (pra ky proces funksionoi vetëm në ¼ pjesë të vitit).

- Futjen në rrugën e zgjidhjes të shumë problemeve të trashëguara, gjë që bën që të pakësohet fluksi i problematikave të mbartura dhe, për rrjedhojë, të ulen edhe aplikimet e lidhura me to.

Ulja e numrit të shërbimeve kadastrale është reflektuar dhe në uljen e të ardhurave financiare për vitin 2022.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023.


2. Koha mesatare e dhënies së shërbimit.

Ky indikator përcakton **kohën mesatare (në ditë) të dhënies së shërbimit nga sportelet e shërbimit të kadastrës**. Indikatori është përcaktuar si diferencë midis ditës së aplikimit nga ana e qytetarit dhe ditës së marrjes së shërbimit, pavarësisht faktit se në cilën datë e ka kryer pagesën qytetari.

Janë përfshirë në llogaritje të gjitha aplikimet e kryera brenda një viti, si ato me përgjigje ashtu edhe aplikimet pa përgjigje.

Për aplikimet që rezultojnë pa përgjigje në atë vit, si datë përgjigje, është vendosur data 31 Dhjetor e po atij viti (p.sh. shifra 101 e vitit 2015 tregon diferencën e ditëve nga data kur është kthyer përgjigje deri në datën e aplikimit).

Koha mesatare e shërbimit								
Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Ditë kalendarike	101	82	103	81	95	24	23	21



Koment: Ky është një nga indikatorët më të rëndësishëm të performancës së një institucioni që ka si bazë dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve. Është kaluar nga një maksimum prej një mesatareje prej 101 ditësh (2017) në një mesatare prej 23 ditësh (2021), duke arritur në një mesatare 21 ditë në vitin 2022.

Ngritja e kësaj kurbe në vitin 2019, u shkaktua kryesisht në muajt e tranzicionit të fuzionit të institucioneve.

Sfida për vitin në vijim do të jetë mbajtja e këtij indikator në këtë nivel dhe përmirësimi i cilësisë së përgjigjeve të dhëna.


Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023.


3. Aplikime pa përgjigje.

Ky indikator paraqet ecurinë e numrit të aplikimeve të qytetarëve që nuk kanë marrë ende shërbimin brenda vitit kalendarik. E shprehur kjo, në shifra dhe në përqindje, në raport më numrin e përgjithshëm të aplikimeve të atij viti.

Aplikime pa përgjigje.

Viti:	Aplikime pa përgjigje	Aplikime pa përgjigje në %
2015	81,746	30,0%
2016	74,713	24,4%
2017	124,517	34,2%
2018	98,057	31,5%
2019	77,926	27,1%
2020	3,559	1,2%
2021	4,763	1,1%
2022	1,957	0.4%





Koment: Me mbylljen e vitit 2022, konstatohet përsëri trendi zbritës, si në përqindje ashtu edhe në numër i aplikimeve që nuk kanë marrë ende përgjigje brenda vitit kalendarik. Numri i aplikimeve pa përgjigje gjatë vitit 2022, është 59% më i ulët se numri i aplikimeve pa përgjigje gjatë vitit 2021.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023.

4. Aplikimet për shërbime kadastrale.


Ky indikator analizon numrin e përgjithshëm të aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera nga qytetarët. Duke nisur nga viti 2020 (Urdhri i KM Nr.153 dt. 25.11.2019, Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, si dhe aktet nënligjore), u mundësua kryerja e të gjithë aplikimeve vetëm online nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania si dhe sistemeve të tjera si Dhoma Kombëtare e Noterisë, ASHK për Institucione (nga nëntor 2020).

Shpjegim: Çdo aplikim përmban kërkesën për 2-4 shërbime kadastrale.

Kryerja e të gjithë aplikimeve vetëm online nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania si dhe sistemeve të tjera solli mënjanimin e radhëve nëpër sportele, deri në eliminim e tyre, si dhe rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve kundrejt Qytetarëve, duke ulur ndjeshëm kohën e marrjes së përgjigjes.

4.1 Numri i përgjithshëm i aplikimeve për shërbime kadastrale.

Viti:	Nr. Total Aplikime *
2020	295,146
2021	433,615
2022	475,260



Koment: Numri i përgjithshëm i aplikimeve për shërbime kadastrale gjatë vitit 2022 është 10% më i lartë se numri i përgjithshëm i aplikimeve gjatë vitit 2021 (ose 41.645 aplikime më shumë).

*Aplikimet u referohen vetëm aplikimeve të paguara.

“Kontradikta” në dukje midis rënies së numrit të shërbimeve dhe rritjes së numrit të aplikimeve, shpjegohet me standardizimin e proceseve të brendshme të punës (p.sh. ndalimi i dhënies së shërbimeve pa aplikimin përkatës, etj.).

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023.

4.2 Aplikimet nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

Ky indikator analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera vetëm në Portalin Qeveritar e-Albania nga qytetarët, për periudhën 2016 deri më 2022. Kjo pasi në vitin 2016 është mundësuar për herë të parë kryerja e aplikimit edhe nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania për 51 Shërbimet që ofronte ish-ZRPP. Sot ASHK ofron 76 shërbime kadastrale.

Viti:	Nr. Aplikimeve nga e-Albania *
2016	29
2017	634
2018	997
2019	902
2020	154,338
2021	189,558
2022	176,622



Koment: Numri i përgjithshëm i aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania gjatë vitit 2022 është 7% më i ulët se numri i aplikimeve të kryera gjatë vitit 2021 (ose 41,645 aplikime më pak).

Ulja e numrit të aplikimeve që realizojnë vetë qytetarët nëpërmjet portalit e-Albania reflektohet tek rritja e aplikimeve të realizuara nëpërmjet sistemit të noterëve NISA (25% më shumë ose 59,702 aplikime më shumë). Gjë që dëshmon ndërgjegjësimin e qytetarëve për të kërkuar shërbim më të specializuar, duke iu drejtuar gjithnjë e më shumë zyrës së noterit.


*Aplikimet u referohen vetëm aplikimeve të paguara.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023

4.3 Aplikime nëpërmjet sistemit të Dhomës Kombëtare të Noterisë NISA.

Ky indikator analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera vetëm nëpërmjet platformës elektronike të Dhomës Kombëtare të Noterisë, i quajtur sistemi NISA, në përdorim nga noteri, përmes zyrës noteriale, që siguron transferimin e sigurt dhe të shpejtë të të dhënave.

Viti:	Aplikime nga sistemi NISA *
2021	236,310
2022	296,012



Koment: Numri i përgjithshëm i aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera nëpërmjet sistemit të noterëve NISA gjatë vitit 2022 është 25% më i lartë se numri i aplikimeve të kryera gjatë vitit 2021 (ose 59,702 aplikime më shumë).

Rritja e numrit të aplikimeve nëpërmjet sistemit NISA reflekton uljen e aplikimeve që realizojnë vetë qytetarët nëpërmjet portalit e-albania. Gjë që dëshmon ndërgjegjësimin e qytetarëve për të kërkuar shërbim më të specializuar duke iu drejtuar gjithnjë e më shumë noterit.

*Aplikimet u referohen vetëm aplikimeve të paguara.


Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023

4.4 Aplikime nëpërmjet modulit “ASHK për Institucione”.

Ky indikator analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera vetëm nëpërmjet modulit “ASHK për Institucione”. Moduli “ASHK për Institucione”, u implementua për të lehtësuar shkëmbimin e informacioneve ndërmjet ASHK-së dhe institucioneve si palë të interesuara. Aplikimet nëpërmjet këtij moduli u mundësuan duke filluar nga muaji dhjetor 2020, për institucionet si ATP, ARRSH, AIDA, ILDKP, Prokuroria, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Ky modul pararel operimi, rrit shpejtësinë e marrjes së informacionit zyrtar nga Institucionet e përcaktuara në Ligjin mbi të drejtën e informimit dhe /ose për nevojat e punës së tyre; ofron lehtësi në ndërveprim (kryerje aplikimi dhe marrje përgjigje), lehtëson procesin e kryerjeve të aplikimeve dhe për gjenerimin e faturave financiare mbi shërbimet e aplikuar. Gjithashtu, duke shkëputur institucionet nga sistemi aktual, në një modul më vetë, rrit shpejtësinë e operimit për qytetarët.

Viti:	Aplikime nga sistemi ASHK për Institucione *
2021	7.747
2022	2.626



Koment: Vihet re një trend zbritës i numrit të aplikimeve të kryera nëpërmjet sistemit ASHK për Institucione, në krahasim me vitin 2021, në 66% më i ulët.

Arsyet e kësaj rënie mund të shpjegohen me faktin se shumë Institucione kanë akses vetë në sistem nëpërmjet user-ave, gjithnjë e më shumë, Institucionet po operojnë nëpërmjet të tretëve (me delegim, konsulenca), gjithashtu, institucionet mund të aplikojnë me NIPT-in e tyre nëpërmjet portalit e-albania.


Sdq duhet një analizë më e thellë nga ana jonë për të interpretuar këtë fenomen.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 10.01.2023

5. Numri i Certifikatave të pronësisë.

Ky indikator analizon numrin e certifikatave të pronësisë të lëshuara nga ish ZVRPP-të dhe ASHK, përgjatë viteve 2015 – 2022.

Viti:	Nr. i certifikatave të pronësisë:
2018	127,220
2019	134,736
2020	144,801
2021	241,640
2022	249,616



Koment: Në zbatim të UDP ASHK Nr. 1361 datë 12.05.2020 “Për nënshkrimin elektronik të akteve kadastrale për shërbimet e ofruara nga ASHK dhe miratimin e procedurës së punës”, të gjitha aktet kadastrale që ofron ASHK (ku bëjnë pjesë dhe certifikatat e pronësisë), **lëshohen vetëm me nënshkrimin dhe vulën elektronike.** Duhet pasur parasysh se deri në vitin 2020, certifikatat e pronësisë plotësoheshin e lëshoheshin me dorë, si rrjedhim saktësia e numrit të tyre deri në vitin 2020, nuk është 100% e saktë.

Numri i certifikatave të pronësisë të lëshuara nga ASHK gjatë vitit 2022 është 3,3% më i lartë se numri i certifikatave të lëshuara gjatë vitit të kaluar 2021 (ose 8006 certifikata pronësie më shumë). **Ky është një nga indikatorët më pozitivë të eficiencës së funksionimit të sistemit.**

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 16.01.2023.


6. Rivlerësimet e pasurive të paluajtshme ndër vite.

Procesi i rivlerësimit të pasurive parashikon që të gjithë individët që kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit përkatës, të bëjnë rivlerësimin e pasurisë së tyre me vlerën e tregut. Procesi i fundit u krye në bazë të ligjit 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar me aktin normativ Nr. 35 datë 24.12.2021, i cili e shtriu afatin e zbatimit të këtij ligji deri në datën 31 prill 2022.

Për herë të parë ky proces është bërë në vitin 2011 dhe ndër vite ka pasur nivel të ndryshëm të taksës së rivlerësimit.

Viti:	2011	2012	2013	2016	2017	2020	2022
Taksa e rivlerësimit	1%	1%	2%	2%	2%	3%	3%

Viti:	Shërbime për rivlerësim	Të ardhura për tatimet:
2011/2012	70,590	2,99 miliard lekë
2013	25,091	0,99 miliard lekë
2016/2017	60,264	5,41 miliard lekë
2020/2022	113.800	12,68 miliard lekë



Rivlerësimi 2020-2022. Procesi i rivlerësimit të pasurive u hap me dt.05.02.2020, u zgjat me ligjin 164/2020, u zgjat sërish me aktin normativ 35/2021 dhe u mbyll më dt.02.08.2022. Afati i aplikimit të qytetarëve për të përfituar nga procesi i rivlerësimit të pronës përfundoi në datën 30.04.2022, ndërsa mundësia për të paguar u shty deri në datën 02.08.2022. Procesi i kryer kësaj radhe, mban rekordin për numrin e qytetarëve që u përfshinë në të.

Të ardhura në buxhetin e shtetit: 12,7 miliard lekë (rreth 110 milion USD).

Koment: Rritja e numrit të rivlerësimeve çdo herë që është marrë kjo nismë, flet për njohjen dhe kuptimin gjithnjë e më të madh nga ana e publikut të vlerës së këtij operacioni.

7. Nafta për Fermerët.


Prej dy vitesh Qeveria Shqiptare po zbaton skemën mbështetëse të naftës pa taksa për bujqësinë. Skema e naftës pa taksa për fermerin synon mbështetjen e prodhimit vendas bujqësor, lehtëson kostot e prodhimit, duke lehtësuar rrjedhimisht buxhetet e fermerëve në punët e bujqësisë.

Realizmi i kësaj skeme u mundësua me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Për ofrimin e shërbimit kadastral për subjektet që përfitojnë nga projekti “Nafta për bujqësinë”, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ASHK-së, me Nr.1150 prot, datë 02.02.2021 dhe Nr.1844 prot, datë 01.02.2021, nëpërmjet zhvillimit të modulit “Popullim dhe përshtatje të Regjistrit Elektronik të Pasurive të Paluajtshme për ofrimin e shërbimit kadastral “Lëshim ekstrakti informues nga sistemi i pasurive të paluajtshme për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nafta për Fermerët”.

Nëpërmjet kësaj kontrate, ASHK merr përsipër t'i sigurojë MBZHR (Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe përdoruesve përkatës) nëpërmjet modulit digjital për institucionet, të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme të subjekteve që përfitojnë nga Projekti “Nafta për Bujqësinë” për çdo aplikim të nisur nga subjekti në portalin qeveritar e-albania., sipas shërbimit kadastral 66/1 “Lëshim ekstrakti informues”.

Tabela e aplikimeve nga AZHBR

Viti:	Nr. aplikime/shërbime
2021	20,000
2022	34,738



Koment: Gjatë vitit 2022 AZHBR ka marrë informacion kadastral për rreth 34.738 subjekte që disponojnë parcela bujqësore, nëpërmjet modulit që ASHK ka ngritur posaçërisht për këtë qëllim. **Nisma “Nafta për Fermerët” ka qenë një ngarkesë shtesë mbi sistemin e zyrave të Kadastrës, por që u përballua pa strese në shërbimin ndaj publikut.**

8. Certifikimi i AMTP-ve.

Procesi i regjistrimit të tokës bujqësore është një nga detyrat më të rëndësishme që i dalin Kadastrës Shqiptare në zbatim të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”. Ndër vite, ka qenë e pamundur të nxirren të dhëna të sakta, pasi qoftë nga Ministria e Bujqësisë dhe qoftë nga ish ZRPP nuk janë mbajtur evidenca mbi ecurinë e këtij procesi.


Ndërkaq, procesin e kanë komplikuar edhe faktorë të tjerë si, ndryshimet e shpeshta ligjore ndër vite, zgjatja e tij jashtë çdo limiti kohor për gati 3 dekada, përfshirja e shumë institucioneve të ndryshme dhe të ndryshueshme kohë pas kohe, etj.

Në përgjithësi konsiderohet të lëshuar në total rreth 454.500 AMTP:

Janë rreth 20.000-25.000 AMTP të reja që parashikohen për t'u plotësuar (që nuk janë pajisur me AMTP në bazë të ligjit 9948/2008 dhe ligjit 171/2014, afati zbatimit të të cilave ka përfunduar në 31.12.2019).

Prej vitit 2020 certifikimi i AMTP-ve të lëshuara është një proces që kryhet i gjithi nga ASHK.

VITI	Nr. Certifikatave për tokën bujqësore
2019	8311
2020	18,576
2021	20,400
2022	18,296



Koment: Lëshimi i certifikatës së pronësisë për tokën bujqësore, varet nga interesi i vetë pronarit/personit të interesuar për të kryer aplikimin përkatës për pajisje me certifikatë në përputhje me Ligjin 111/2018 “Për Kadastrën”. Sdq, rënia e certifikimeve për vitin 2022, lidhet edhe me faktin se tanimë ASHK është e angazhuar edhe në procesin e plotësimit (pajisjes) me tokë bujqësore të subjekteve përfitues sipas Ligjit 7501, i shfuqizuar dhe që ende nuk ka dhënë rezultatet e veta. **Procedura e re e plotësimit me AMTP, paraqet shumë sfida për ASHK-në, për sa i takon marrëveshjes midis përdoruesve të tokës bujqësore me kufitarët.**

Shënim: Të dhënat për indikatorin e certifikimit të AMTP-ve merren dhe rakordohen nëpërmjet raportimeve periodike të DV/ZV të ASHK-së dhe jo nëpërmjet sistemit. Të dhënat i përkasin datës 16.01.2023.

II. PROCEDURA ADMINISTRATIVE E LEGALIZIMIT




 www.ashk.gov.al  08008811

9. Legalizimet.

Ky indikator mat numrin e objekteve të legalizuara në vite nga ish-ALUIZNI dhe sot nga ASHK.


Tabela për progresivin e legalizimit.

PERIUDHA:	LEJE LEGALIZIMI 2006 - 2021
2006-2009	1.583
2010	3.404
2011	7.410
2012	13.179
2013	21.750
2014	37.044
2015	61.792
2016	110.143
2017	136.594
2018	166.745
2019	178.763
2020	199.754
2021*	223.771
2022*	243.659



Leje Legalizimi sipas viteve.

VITI:	LEJE LEGALIZIMI:
2006-2009	1.583
2010	1.821
2011	4.006
2012	5.769
2013	8.571
2014	15.294
2015	24.748
2016	48.351
2017	26.451
2018	30.151
2019	12.018
2020	20.991
2021*	24.017
2022*	19.888
Total	243.659




Koment: Ulja e numrit të vendimmarrjeve për legalizim, lidhet me faktin që procesi i legalizimit po shkon drejt përfundimit. **Në një pjesë të territorit ASHK ka deklaruar përfundimin e këtij procesi.**

(*) Të dhënat për dy vitet e fundit janë ende në përpunim, kjo për shkak të përditësimit të sistemit të monitorimit, si rrjedhim i kalimit nga modeli “leje legalizimi” në “vendimmarrje” të arsyetuar, në përputhje me VKM 1040/2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit të ndërtimit pa leje”. Si rrjedhim, numri i përgjithshëm i dy viteve të fundit (2021,2022) nuk ndryshon, por ndryshojnë të dhënat ndërmjet këtyre dy viteve. Të dhënat janë gjeneruar në datën 16.01.2023.

10. Përrjashtimi nga legalizimi i ndërtimeve pa leje.

Ky indikator mat numrin e vendimmarrjeve për moslegalizim të ndërtimeve pa leje, të marra në vite nga ish-ALUIZNI dhe sot nga ASHK.

VITI:	VENDIME PËR MOSLEGALIZIM:
2006-2013	Gjithsej 1,019
2014	356
2015	238
2016	405
2017	293
2018	583
2019	210
2020	94
2021	159
2022	410
TOTAL	3,767



Koment: Numri i vendimeve për moslegalizim të ndërtimit informal, deri më tani ka qenë kryesisht në varësi të kërkesave për përjashtim, të paraqitura nga institucionet shtetërore, që kanë si objekt të veprimtarisë kontrollin mbi territorin, si dhe ato që kanë zbatuar projekte të infrastrukturës publike. Për të gjitha këto vendimmarrje, ASHK ka krijuar bazën përkatëse të të dhënave (skeda digjitale), e cila mundëson trajtimin e subjekteve që nuk u legalizohet ndërtimi, përmes skemave të trajtimit financiar.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 16.01.2023.


11. Legalizimi i pallateve të braktisura nga ndërtuesit.

Procesi i legalizimit të pallateve, ndahet në dy kategori, në pallatet e zakonshme të pabanuara dhe në pallatet e braktisura nga ndërtuesit dhe të banuara. Problematika e trashëguar ka qenë kjo e dyta. Në këtë kategori, përfshihen pallatet pa leje ndërtimi, me shkelje të lejes së ndërtimit, rastet kur ndërtuesi ka falimentuar apo e ka braktisur procesin e legalizimit, etj. dhe ndërkohë objekti është i banuar.

Sipërfaqe ndërtimi e trajtuar:

SIPËRFAQE BANIMI (M2)	2,160,871
SIPËRFAQE SHËRBIMI (M2)	746,058
SIPËRFAQE TOTALE	2,906,929

VITI	Pallate të legalizuara:
2006 - 2013	167
2014	22
2015	105
2016	82
2017	107
2018	79
2019	83
2020	158
2021	156
2022	85
TOTAL	1,044



Koment: Për zonat urbane, **ky proces është një histori suksesi, me të njëjtën rëndësi si vetë procesi i legalizimeve për zonat rurale.** Legalizimi i pallateve po shkon drejt përfundimit. Rënia e kësaj kurbe e filluar që vitin 2021 dhe e thelluar në vitin 2022, lidhet me faktin që **ky proces po fillon të shkojë drejt fundit dhe po mbeten për trajtim ato raste që kanë komplikacione të theksuara** (procese gjyqësore, mosmarrëveshje, etj.)

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 16.01.2023.


12. Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991.

Ky proces ka të bëjë me pajisjen me dokumente pronësie për banesat e vjetra të ndërtuara në të gjitha epokat përpara vitit 1991 dhe të cilat nuk kanë qenë regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme.

Procesi ka filluar në vitin 2012 nga Bashkitë, mbi bazën e VKM nr. 608/2012, “Për përcaktimin e procedurës ...”. Me VKM 442/2018 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit ...”, kjo procedurë që ishte funksion i Bashkive, kaloi në ngarkim të ish-ALUIZNI-t. Sot procesi kryhet nga ASHK, në zbatim të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe VKM-së Nr. 827 datë 30.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim”.

Tabela e objekteve të formalizuara nga Bashkitë dhe ASHK sipas viteve:

VITI:	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
BASHKITË	120	110	100	80	120	100	110	-	-	-	-
ASHK	-	-	-	-	-	-	-	249	1.521	2.211	1.699



Koment: Për periudhën 2012-2018, kur ky proces realizohej nga Bashkitë, mund të thuhet se ka qenë praktikisht i braktisur, me një mesatare prej rreth 100 objektiv të formalizuara në vit në rang Republike.

Vihet re një ulje e numrit të objekteve të formalizuara gjatë vitit 2022, që vjen kryesisht si rrjedhim i vështirësive që hasen për të identifikuar ndërhyrjet e reja që janë kryer mbi këto objekte përgjatë viteve. **Sdq, kërkohet më shumë impenjim nga ana e drejtorive Vendore në trajtimin e këtij stoku.**


Shënim: Të dhënat i përkasin datës 16.01.2023. Të dhënat merren nëpërmjet raportimeve periodike të DV/ZV të ASHK-së dhe jo nëpërmjet sistemit.

13. Kompensimi i pronarëve të truallit të zënë nga ndërtimet pa leje.

Për të përfunduar procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, është i domosdoshëm kompensimi financiar i pronarëve privat të cilëve u është zënë trualli. Nga viti 2008 e në vijim, ky proces i realizuar nga ASHK, paraqitet sipas tabelës vijuese.


VITI	Nr. i pasurive të trajtuara
2008	31
2009	232
2010	75
2011	291
2012	199
2013	335
2014	50
2015	415
2016	493
2017	231
2018	731
2019	1,024
2020	1,933
2021	1,443
2022	1,547

Grafiku i mëposhtëm, paraqet numrin pasurive të trajtuara sipas VKM-ve përkatëse për kompensimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të zëna nga ndërtimet pa leje.



Koment: Të ardhurat që sigurohen nga ky proces shkojnë për shpërblimin e ish-pronarëve dhe **përbëjnë burimin kryesor në rang vendi për procesin e kompensimit të tyre nga Agjencia e Trajtimit të Pronës.**


III - PROCESI I PËRMIRËSIMIT HARTOGRAFIK



14- Procesi i përmirësim/përditësimit të blloqeve kadastrale.

Përmirësim/përditësimi i blloqeve kadastrale është një proces i rëndësishëm, që ka për qëllim të rregullojë pasaktësitë dhe gabimet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Viti	Nr. Blloqe Kadastrale
2016	385
2017	139
2018	27
2019	21
2020	40
2021	104
2022	35




Koment: Në vitet 2016, 2017, numri i blloqeve kadastrale të përditësuara rezulton artificialisht i lartë, pasi në këtë shifër përfshihen dhe blloqet e përpunuara nga TAP (Trans Atlantic Pipeline). Pavarësisht se janë punuar nga punonjësit e TAP, konsideroheshin si blloqe të përmirësuar nga zyra vendore e ish ZVRP-së përkatëse. Rënia e numrit të blloqeve të përditësuara në krahasim me vitin 2021, vjen si rezultat se gjatë vitit 2022 procesi i përmirësim/përditësimit ka kaluar nga çdo drejtori vendore (që kryhej më parë) dhe është qendëruar në Qendrën e Kadastrës Digjitale, e cila filloi nga puna në muajin Prill 2022. Kjo situatë kërkon rishikim të procesit të punës dhe raporteve QKD-DV.

15. Ecuria e procesit të Regjistrimit Fillestar.

Regjistrimi sistematik për herë të parë i pasurive të paluajtshme është një proces i hershëm, i nisur që në vitin 1994-1995. Në vitin 2020, ASHK ka nisur procesin e regjistrimit fillestar të 8 zonave të jugut të Shqipërisë.

Në vijim, paraqitet ecuria e regjistrimit fillestar sipas viteve.

Viti	Numri i pasurive të përfshira në regjistrimin fillestar
2015	21,500
2016	60,836
2017	30,808
2018	34,517
2019	62,162
2020	28,553
2021	23,521
2022	9,572



Viti	Pasuri të përfshira në regjistrimin fillestar Progressive
2015	3,088,000
2016	3,298,000
2017	3,319,500
2018	3,380,336
2019	3,411,144
2020	3,445,661
2021	3,507,823
2022	3,569,469




Tabela e mëposhtme paraqet një evidencë të situatës aktuale të zonave kadastrale të trajtuara me regjistrim fillestar.

Vendndodhja	ZK	Qyteti	Autoriteti që e trajton	Faza e punës
Kukës	3425	Shtiqën	Bashkia Kukës (Marrëveshje ish ZQRPP)	Përfunduar
	2315	Qytet	ASHK	Në trajtim
Bulqizë	3444	Shupenzë	Bashkia Bulqizë (Marrëveshje ASHK)	Përfunduar
	8522	Qytet	ASHK	Në trajtim
	8524	Qytet	ASHK	Kryer Afishim Publik
	8525	Qytet	ASHK	Në trajtim
	1085	Balldre	ASHK	Përfunduar
Krujë	2237	Kosovë	Bashkia Elbasan	Kryer Afishimi Publik
	8621	Qytet	ASHK	Në trajtim
Lushnjë	8571	Qytet	ASHK	Në trajtim
	8572	Qytet	ASHK	Në trajtim
Shkodër	8594	Qytet	ASHK	Në trajtim
Sarandë	2603	Markat	ASHK	Kryer Afishimi Publik
	2801	Ninat	Bashkia Konispol (Marrëveshje ish ZQRPP)	Përfunduar
	1997	Janjar	Bashkia Konispol (Marrëveshje ish ZQRPP)	Përfunduar
	1013	Aliko	Bashkia Finiq (Marrëveshje me ASHK)	Përfunduar
Belsh	1386	Çërragë	Bashkia Belsh (Marrëveshje ish ZQRPP)	Përfunduar
Fier	1451	Darzezë	Bashkia Fier (Marrëveshje ish ZQRPP)	Kryer Afishimi Publik
	2329	Kuqar	ASHK	Përfunduar


Librazhd	3087	Qarrishtë	Bashkia Librazhd (Marrëveshje ish ZQRPP)	Përfunduar
Kolonjë	3117	Qinam	ASHK	Në trajtim
Himarë	2863	Palasë	ASHK	Kryer Afishimi Publik
	1739	Gjilekë	ASHK	Përfunduar RF për një pjesë. Në trajtim pjesa tjetër
	1481	Dhërmi	ASHK	Përfunduar RF në dy blloqe Në proces Afishimi Blloku 3
	1982	Ilias	ASHK	Përfunduar
	3844	Vuno	ASHK	Përfunduar RF për një pjesë. Në trajtim pjesa tjetër
	1952	Himarë	ASHK	Përfunduar RF për bllokun 1.Kryer Afishimi Publik për bllokun 2
	2518	Lukovë	ASHK	Përfunduar RF për bllokun 1 dhe 2.Ne afishim blloku 3
	2806	Nivicë	ASHK	Në trajtim
Vlorë	3269	Sazan	ASHK	Përfunduar
Pogradec	1208	Bllacë	Bashkia Pogradec (Marrëveshje me ASHK)	Përfunduar
Gjirokastër	8541	Qytet	ASHK	Përfunduar
Malësi e Madhe	3158	Reç	Bashkia Malësi e Madhe (Marrëveshje me ASHK)	Përfunduar
Bulqizë	1764	Gjoricë e Poshtme	Bashkia Bulqizë (Marrëveshje ASHK)	Përfunduar

Koment: Gjatë vitit 2022 kanë përfunduar edhe zonat e fundit të jugut të Shqipërisë. Ndërkohë, ASHK parashikon regjistrimin fillestar për 20 zona kadastrale për vitin 2023. Me përfundimin e regjistrimit fillestar në zonat e financuara nga Donatorë, aktualisht ky proces përballohet vetëm me fonde të brendshme të ASHK.

16. Liqjërimi dhe përfshirja e pasurive në bazën e të dhënave (ALBSCAD).

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të pasurive të ngarkuara në bazën elektronike të të dhënave të pasurive të paluajtshme (ALBSCAD).

Viti	Nr. pasurive të ngarkuara në sistem
Para vitit 2014	227,445
2014	240,434
2015	240,590
2016	283,061
2017	237,906
2018	173,342
2019	197,905
2020	114,700
2021	164,246
2022	265,918



Koment: Në vitin 2020 ka një rënie të theksuar të numrit të pasurive të ngarkuara në sistem. Kjo ndodh themelisht prej faktit që në vitet paraardhëse numri i pasurive të ngarkuara në sistem ka qenë vërtet i madh, por saktësia e tyre ka qenë shumë e ulët (raporti i VBB sipas të cilit 80% e pasurive duhen përmirësuar).

Në ndryshim prej tyre, **pasuritë e ngarkuara në sistem në vitin 2020, 2021 dhe 2022 janë me saktësi të lartë** dhe nuk kanë nevojë për saktësime shtesë.

KADASTRA DIGJITALE



17. Qendra e Kadastrës Digjitale

Qendra e Kadastrës Digjitale është krijuar me urdhër të Kryeministrit Nr.15 datë 31.01.2022 “ Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” dhe VKM Nr.747 datë 9.12.2021 “Për financimin e projektit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme”.

Ky projekt ka si qëllim digjitalizimin e Kartelave të Pasurive të Paluajtshme dhe skanimin e Dokumenteve Tekniko-Ligjorë. Digjitalizimi i Kartelave bazohet në formatin e kartelës përcaktuar me VKM Nr. 782, datë 07.10.2020, standardet e dokumenteve digjitale, strukturën e bazës së të dhënave të sistemit të kompjuterizuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme AALBSCAD, Rregulloren e Punës së AALBSCAD dhe dokumente të tjerë që lidhen me digjitalizimin e të dhënave.

Me krijimin e Qendrës së Kadastrës Digjitale, synohet digjitalizimi i gjithë arkivës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, digjitalizimi i kartelave të pasurive të paluajtshme së bashku me skanimin e të gjithë materialit shkresor të referencave të administruara në zyrat e kadastrave, përfundimi i regjistrimeve fillestare të zonave të ndryshme në Shqipëri të cilat ende nuk kanë një hartë digjitale të pasurive të paluajtshme në atë territor, si dhe përmirësim, përditësim të hartave në zonat ku këto të fundit kanë probleme si, spostimet apo mos koordinim me gjendjen faktike.

Qëllimi final i këtij Projekti synon:

- Rritjen e saktësisë së Informacionit për qytetarët
- Rritjen e shpejtësisë së dhënies së shërbimit
- Rritjen e sigurisë së pronës

Nga 4 milion pasuri të paluajtshme për të cilat ka përfunduar regjistrimi fillestar, rreth 700 000 pasuri janë të digjitalizuara (kartelat, hartat kadastrale dhe dokumentacioni tekniko-ligjor). Këto të dhëna janë të ngarkuara dhe mbahen të përditësuara në Sistemin ALBSCAD. Përveç tyre ish ZVRPP-të kanë krijuar në mënyrë sporadike kartela digjitale për rreth 1.000.000 pasuritë për të cilat është aplikuar nga qytetarët. **Pra, digjitalizimi i plotë i të dhënave të kartelës duhet kryer për rreth 2.3 milion kartela dhe digjitalizimi i pjeshëm për rreth 1 milion kartela.**

Duke marrë parasysh punën voluminoze, numrin e madh të punonjësve dhe shtrirjen në të gjithë territorin e Shqipërisë, është përlogaritur një kosto totale e vlerësuar e projektit prej 731.142 000 lekë.

Ritmi ditor i punës së sektorit të digjitalizimit është rreth 4.900 kartela të digjitalizuara dhe rreth 50.000 apo 90.000 dokumente (fletë).

Ritmi ditor i punës i sektorit të skanimit të referencave dhe volumeve është rreth 4.500 referenca të skanuara në ditë ose rreth 112.500 fletë në ditë.

Gjatë vitit 2022, Qendra e Kadastrës Digjitale ka përfunduar punën për Digjitalizimin e kartelave dhe Skanimin e Referencave për DVASHK Lushnje dhe ZVASHK Tropojë. Ky proces do të shtrihet në të gjithë zyrat e Republikës së Shqipërisë.

Procesi i digjitalizimit të kartelave të pasurive të paluajtshme nënkupton dhënien e shërbimit në mënyrë sa më të shpejtë dhe të sigurt nga ana e zyrave vendore por edhe faktin se qytetari do e ketë shumë afër historikun e pronave të veta. Qytetarët nuk do kenë më përballë kadastrën por do të kenë një sistem i cili në arkivat e veta digjitale i ka të gjitha transparente, dhe me një klik do të kesh shkresën e pronës në telefonin tënd.

QKD / SEKTORI I DIGJITALIZIMIT			
DV/ZV	Kartela/Pasuri	Volume	ZK
DV LUSHNJE	167,000	710	122
ZV TROPOJË	37,000	148	72
TOTAL	204,000	858	194

Aktualisht, ka filluar puna për përmbylljen e procesit të digjitalizimit të DVASHK DURRËS duke sigluar çdo kartelë pasurie me nënshkrim elektronik.

DVASHK DURRES: Total 1062 Volume ose 265 500 kartela pasurie për t'u digjitalizuar.

Procesi i skanimit nënkupton skanimin e të gjithë referencave të të gjithë pronave në këto qytete, administrimin e tyre në server digjital me qëllim ruajtjen dhe transparencën e informacionit.

Skanimi i Referencave

QKD / SEKTORI I SKANIMIT		
DV/ZV	REFERENCA	FLETË
DV LUSHNJE	92,000	2,300,000
ZV TROPOJË	12,000	300,000
DV DURRËS	189,000	4,725,000
DV KRUIJË	51,000	1,275,000
DV KAVAJË	64,000	1,600,000
TOTAL	408,000	10,200,000

Shënim: Me ngjyrë jeshile paraqiten DV/ZV në të cilat është mbyllur procesi i skanimit të referencave.

Me ngjyre kafe janë paraqitur Drejtoritë në të cilat vazhdon procesi i skanimit të referencave.

Në DV Durrës, nga 240,000 referenca që janë në total, janë skanuar deri tani 189,000 referenca.

Në DV Kavajë, nga 120,000 referenca që janë në total, janë skanuar deri tani 64,000 referenca.

Skanimi Volumeve të kartelave të pasurive.

QKD / SEKTORI I SKANIMIT		
DV/ZV	VOLUME	FLETË/KARTELA
DV LUSHNJE	710	167,000
ZV TROPOJË	148	37,000
DV DURRËS	800	200,000
TOTAL	1658	404,000

Shënim: Me ngjyrë jeshile paraqiten DV/ZV në të cilat është mbyllur procesi i skanimit të volumeve. Me ngjyrë kafe janë paraqitur Drejtoritë në të cilat vazhdon procesi i skanimit të volumeve. Volumet fizike të kartelave të pasurisë të DV Lushnje dhe ZV Tropojë janë sekretuar.

Në DV Durrës, nga 1,062 volume që janë në total, janë skanuar deri tani 800 volume. Vetë puna në QKD shërben edhe si një shkollë ku përfitohet eksperiencë nga rekrutimet e reja, për të kaluar më pas si punonjës të specializuar pranë DV.

IV - AKTET NËNLIGJORE

18. Ecuria e Akteve nënligjore.

Në zbatim të Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore përkatëse.

Aktualisht, deri në datën 16.01.2023, për ligjin 111/2018 nga 17 akte nënligjore të parashikuara, janë miratuar 16 akte.

Për ligjin 20/2020 nga 19 akte nënligjore të parashikuara janë miratuar 16 akte.

Në dy Tabelat e mëposhtme, paraqitet ecuria e akteve nënligjore përkatëse, të miratuara dhe përcjellë për miratim në Këshillin e Ministrave, në zbatim të ligjeve 111/2018 dhe 20/2020.

Aktet nënligjore të miratuara dhe përcjellë për miratim në zbatim të Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”

Nr.	Emërtimi i projektaktit	Statusi
1	“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave si dhe të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrative në ASHK”	Miratuar me VKM nr.245, datë 24.04.2019
2	“Për përcaktimin e rregullave të funksionimit të Këshillit Drejtues të ASHK-se dhe për masën e shpërbimit për veprimtarinë e anëtarëve”	Miratuar me VKM nr.244, datë 24.04.2019
3	“Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues”	Miratuar me VKM nr.175, datë 04.04.2019
4	“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ASHK-së”	Miratuar me Urdhër KM nr.15, datë 31.01.2022
5	“Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2020”	Miratuar me VKM nr.117, datë 13.02.2020
6	“Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”	Miratuar me VKM nr.329, datë 22.05.2019
7	“Për modelin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020
8	“Për modelin e certifikatës së pronësisë dhe certifikatave për të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020
9	“ Për të dhënat në përmbajtje të hartës kadastrale”	Miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020
10	“Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”	Miratuar me VKM nr.781, datë 07.10.2020
11	“ Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive të tjera natyrore”	Miratuar me VKM nr.605, datë 29.07.2020
12	“Për listën e shërbimeve kadastrale dhe tarifave të tyre”	Miratuar me VKM nr.389, datë 13.05.2020
13	“Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.1179, datë 24.12.2021
14	“Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e të drejtës nga personat juridik/fizike vendas apo te huaj për të patur akses në sistemin elektronik dhe lista se institucioneve”	Miratuar me VKM nr.1179, datë 24.12.2021

15	“Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga ASHK”	Miratuar me VKM nr.864, datë 27.12.2022
16	“Për rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.4, datë 11.01.2023,
17	“Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi”	Përcjellë në KM për shqyrtim me shkresën nr.19555 prot., datë 28.10.2022

Aktet e miratuara dhe përcjella për miratim në zbatim të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”

Nr.	Emërtimi i projektaktit	Statusi
1	“Procedurat e hollësishme për regjistrimin e AMTP, saktësimin e kufijve dhe sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë dhe pronat shërbyese”	Miratuar me VKM nr.1174, datë 24.12.2020
2	“Për rregullat e hollësishme dhe formën e aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”	Miratuar me VKM nr.1182, datë 24.12.2020
3	“Për procedurat, dokumentacionin dhe kushtet e kualifikimit për legalizim”	Miratuar me VKM nr.1040, datë 25.11.2020
4	“Për modelin dhe rregullat për nxjerrjen e aktit të legalizimit”	Miratuar me VKM nr.1040, datë 25.11.2020
5	“Për rregullat e hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë për objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim”	Miratuar me VKM nr.827, datë 30.09.2020
6	“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”	Miratuar me VKM nr.1178, datë 24.12.2020
7	“Për procedurat e veçanta të legalizimit, në favor të poseduesve si dhe rregullat për përfundimin e procedurës nga subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese/investitore”	Miratuar me VKM nr.1180, datë 24.12.2020
8	“Për mënyrat e trajtimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërbllimit financiar, format alternative të trajtimit për poseduesit e ndërtimeve të përjashtuar nga legalizimi, si dhe rregullat dhe afatet për realizimin e tyre”	Miratuar me VKM nr.409, datë 15.10.2022
9	“Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluar afatet, mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen dhe modelin e aktit për kalimin e pronësisë”	Miratuar me VKM nr.1189, datë 24.12.2021
10	“Për rregullat e hollësishme të krijimit, përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për proceset kalimtare të pronësisë si dhe ndërveprimet me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”	Miratuar me VKM nr.1181, datë 24.12.2021
11	“Për rregullat e hollësishme për hartimin e planit të riveimit për zonat e stimuluar	Miratuar me VKM nr.429, datë 15.07.2021
12	“Për rregullat e zbatimit të paragrafit 9 të nenit 69 të ligjit nr.20/2020 “ Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”	Miratuar me VKM nr.1178, datë 24.12.2020
13	“Për përmbajtjen e bazës së të dhënave të ndërtimeve pa leje, mënyrën e plotësimit, përpunimit të të dhënave, lëshimin e ekstrakteve, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”	Miratuar me VKM nr.1181, datë 24.12.2020
14	“Për procedurat e hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullat për bashkëpunim mes institucioneve”	Miratuar me VKM nr.28, datë 27.01.2023
15	“Për rregullat e hollësishme të bashkërendimit të punës ndërmjet ASHK dhe ATP”	Përcjellë për shqyrtim në KM me shkresën nr.1079 prot., datë

		19.01.2022 dhe nr.10787 prot, datë 24.05.2022
16	“Për procedurat e hollësishme që zbatohen për kalimin e pronësisë dhe modeli i aktit të kalimit të pronësisë të trojeve shtetërore në përdorim”	Projektvendimi është përcjellë nga ASHK për shqyrtim në KM me shkresën nr.8253 prot., datë 15.04.2022
17	“Për vlerat e tarifave të shërbimit, pagesave, masat e penaliteteve si dhe për mënyrën e llogaritjes, mbledhjes dhe administrimit të tyre”	Miratuar me VKM nr.5, datë 11.01.2023
18	“Për rregullat e hollësishme për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, pagesën, çmimin favorizues, kategoritë e subjekteve që përfitojnë falje, si dhe përqindjet e përdorimit të bonove të privatizimit”	Draftuar, në fazë konsultimi, programuar në PPAP 2023
19	“Për kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje me funksion banimi që kanë pësuar dëme si pasojë e fatkeqësive natyrore”	Miratuar me VKM nr.865, datë 27.12.2022

Koment: Aktualisht, deri në datën 30.01.2023:

-për ligjin 111/2018, nga 17 akte nënligjore të parashikuara, janë miratuar 16 akte.

-për ligjin 20/2020, nga 19 akte nënligjore të parashikuara, janë miratuar 16 akte.

Me përfundimin e miratimit edhe të korpusit të akteve nënligjore, tashmë puna e ASHK për këtë vit do të fokusohet në hartimin dhe miratimin e akteve të nivelit të tretë: rregullore të brendshme, manuale operimi, etj.


V - SITUATA FINANCIARE

19. Të ardhurat/shpenzimet e realizuara në vite.

Të dhënat përfshijnë të ardhurat e realizuara nga ASHK që nga periudha e krijimit të saj (Mars 2019), si dhe institucionet e përfshira tashmë në të, ish ZRPP dhe ish ALUIZNI, sipas viteve përkatëse.

Të ardhurat dhe shpenzimet në nivel kombëtar, për periudhën 2008-2022:

VITI:	Të Ardhura Total	Shpenzimet total
2008	560,540,449	892,933,064
2009	719,900,381	1,083,193,461
2010	658,099,854	1,013,134,675
2011	786,329,537	952,880,642
2012	1,505,373,515	943,629,658
2013	1,578,304,117	1,060,495,458
2014	1,517,810,922	1,364,336,237
2015	2,505,788,404	1,972,673,124
2016	2,289,443,408	2,532,732,874
2017	2,329,824,961	2,081,156,625
2018	2,152,790,125	1,978,301,869
2019	1,997,513,905	2,029,924,073
2020	2,266,006,782	2,125,218,989
2021	3,227,750,405	2,117,240,304
2022*	2,796,375,250	2,570,648,817



Komente:

- Për periudhën 2019-2022 shpenzimet janë rritur shumë, pasi Institucionit i janë bashkuar funksione dhe institucione të tjera, të cilat që nuk krijojnë të ardhura dhe pa u shoqëruar me faturën financiare të tyre.

Nga raportimet e deritanishme rezulton se të ardhurat gjatë vitit 2022 janë ulur me 13%, ndërsa shpenzimet janë rritur.

Situata financiare në lidhje me shërbimet me paspagim.

Gjatë vitit 2022, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka ofruar 48,073 shërbime kadastrale me vlerë 19.338.800 lekë për institucionet të cilat, sipas pikës 9, të VKM-së Nr.389, datë 13.05.2020 "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale", si dhe Ligjit Nr.111/2018 "Për Kadastrën", përjashtohen nga parapagimi i tarifave për shërbimet kadastrale, por që duhet t'i shlyejnë ato në muajin pasardhës. Këto shërbime në pjesën më të madhe, nuk janë paguar nga Institucionet përkatëse. Këtu përfshihen institucione si Prokuroritë, Gjykatat, Policia e Shtetit, sistemi i institucioneve të Vetingut, ILDKP (Autoriteti përgjegjës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive), Autoriteti shtetëror përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, Avokati i Shtetit, etj.

Institucionet e përmendura në pikën 9, kanë shlyer pjesërisht detyrimin për shërbimet e ofruara nga ASHK në vlerën 7,193,400 lekë. Rezulton se të ardhurat e munguara nga institucionet që përjashtohen nga parapagimi i tarifave për shërbimet kadastrale për vitin 2022, të jetë në total 12,145,200 lekë. Kjo shumë i shtohet detyrimit total të Institucioneve me paspagim, të mbartur që nga hyrja në fuqi e VKM-së së sipërpërmendur (pra që nga muaji Maj i vitit 2020), i cili është 57,228,700 lekë

Koment: Mosshlyerja masive e detyrimeve për shërbimet e marra nga ana e të tretëve, krijon efekte negative në situatën financiare të agjencisë. Kjo problematikë kërkon një trajtim emergjent (!!!).

** Të dhënat për vitin 2022 janë paraprake. Të dhënat e sakta dalin pas mbylljes së bilancit vjetor të ASHK-së.*

Bazuar në rakordimet bankare të Drejtorive Vendore, datë 12.01.2023, në rritjen e shpenzimeve për vitin 2022, kanë ndikuar:

- 1. Ngritja e Qendrës Digjitale të Kadastrës.*
- 2. Pagesa e shpenzimeve gjyqësore për gjyqin e Arbitrazhit, në vlerën 149,350,079 lekë.*
- 3. Rritja e shpenzimeve për investime në vlerën 153,378,075, për vitin 2022, pasi në vitin 2021 nuk ka pasur likuiditetet për këtë zë veçanërisht në rikonstruksionin e objekteve.*
- 4. Rritja e pagave në masën 7 %.*

Në uljen e të ardhurave, ka ndikuar rënia e numrit të kërkesave për shërbime kadastrale, si rrjedhim dhe i mbylljes së procesit të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme.

20. Sistemi i zyrave

ASHK, prej institucioneve paraardhëse (ZRPP dhe ALUIZNI) trashëgoi një situatë të keqe për sa i përket godinave në të cilat ushtrohet aktiviteti. Nëse ZRPP kishte godina të cilat kishin nevojë për ndërhyrje rikonstruksioni, ALUIZNI në një pjesë të konsiderueshme ushtronte aktivitetin në ambiente private të mara me qira e një pjesë tjetër në godina bashkërisht me institucione të tjera.

Me bashkimin e institucioneve situata fillimisht u rëndua pasi një pjesë e drejtorive punonin të ndarë në dy godina. Tërmeti i 2019 e rëndoi edhe më shumë këtë situatë.

Situata me godinat ku ishin vendosur zyrat e ZRPP në vitin 2019, **ishte shumë e keqe**. Një pjesë e konsiderueshme e drejtorive rajonale ishin të vendosura në ambiente private të mara me qira, një pjesë tjetër ishin vendosur në godina bashkërisht me institucione të tjera dhe vetëm një pjesë e vogël ishin vendosur në ambiente të vetat pavarësisht se edhe këto përgjithësisht të pamjaftueshme dhe në gjendje të keqe.

Me Bashkimin e institucioneve situata fillimisht u rëndua edhe më shumë.

Brenda dy viteve, **situata ka ndryshuar me themel**.

- Është përfunduar vendosja në godina të reja për 9 Drejtori Rajonale.
- Janë kaluar në pronësi të vetë institucionit shumica e zyrave të tjera që ende nuk kishin as dokumentacionin e pronësisë për vetë zyrat e veta.
- Janë në proces restaurimi 6 drejtori vendore.

	Drejtori në godina me qira:	Drejtori në godina të reja:	Godina të regjistruara
2019	7	0	4
2020	2	8	16
2021	5	1	18
2022	11	0	18

Duhet pasur parasysh se përmirësimi i situatës së infrastrukturës së godinave të institucionit, ka lidhje direkte me:

- Përmirësimin e dinjitetit të shtetit;
- Përmirësimin e performancës dhe kushteve të punës së stafeve;
- Ruajtjen e arkivave të trashëguara dhe atyre që shtohen vazhdimisht.

Në vitin 2022 kanë kaluar në përgjegjësi administrimi të ASHK-së:

- 2 katet e godinës kryesore me adresë Rruga "Jordan Misja", Tiranë për të cilat kanë filluar procedura për rikonstruksion,
- shtohet sipërfaqja e Drejtorisë së Vlorës me ambientet që ka pasur ADISA.

Koment: Duke pasur parasysh rëndësinë e arkivave që administrojnë këto zyra në një shtet serioz, zyrat e kadastrës janë nga institucionet më të rëndësishme të shtetit.


QARKU:	Godinat ku ushtrojnë aktivitetin drejtoritë e ASHK-së	Gjendja e godinave sot
Drejt. Përgj. ASHK	Stafi punon në godinën në përgjegjësi administrimi të ASHK-se dhe ambiente të tjera me qira	Ambientet kanë nevojë për rikonstruksion pasi është dëmtuar nga tërmeti, për të cilën është kryer aktekspertiza e thelluar
Drejtoritë Vendore Tiranë	Stafi punon përkohësisht në ambiente me qira pranë TBP, në pritje të përfundimit të rikonstruksionit të ambienteve të Ish-ZRPP.	Në proces restaurimi 4 katet e dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Në 2022 janë kaluar në përgjegjësi administrimi edhe dy katet e tatimeve (në proces leje rikonstruksioni)
Kavajë	Ambiente me qira pranë TBP	Vijojnë të punojnë në ambiente me qira.
Berat	Stafi punon në dy godina, njëra e ish ZVRPP dhe tjetra e Albtelecom, në kushte të vështira.	Vijojnë të funksionojë në dy godina të ndara. Është i domosdoshëm sigurimi i ambienteve të tjera.
Kuçovë	Punohet në ambientet e ish Zvrpp Kuçovë	Ambientet janë në gjendje të mirë.
Durrës	Stafi punon në ambiente me qira pranë TBP.	Punohet në ambiente me qira
Krujë	Stafi punon në ambiente me qira pranë TBP.	Punohet në ambiente me qira
Dibër	Punohet në godinën e Ish ZVRPP	Ambientet janë në gjendje të mirë
Elbasan	Stafi punon në godinë të re të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje të mirë
Fier	Stafi punon në godinë të vënë në dispozicion nga Bashkia, sipas një marrëveshje me të, pasi funksiononte i ndarë në 2 godina.	Vendosur në godinë të re, sipas një marrëveshje me Bashkinë.
Lushnje	Stafi punon në godinë të re të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje të mirë
Gjirokastrë	Stafi punon në dy godina, njëra e ish ZVRPP dhe tjetra private me qira, në pritje të marrjes në dorëzim të godinës së DP Arkivave.	Është kaluar me VKM godina e ish Arkivit, por nuk është marrë në dorëzim për arsye administrative të vetë Arkivit, gjithashtu godina ka të domosdoshme rikonstruksionin.
Tepelenë	Punohet në ambientet e ish ZVRPP	Ambientet janë në gjendje të mirë.
Korçë	Stafi punon në godinë të re të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje relativisht të mirë
Pogradec	Punohet në ambientet e Ish ZVRPP	Në gjendje relativisht të mirë.
Kukës	Punohet në ambientet e Ish ZVRPP, deri në rikonstruksionin e godinës së marrë në pronësi.	Godina është në procedurë rikonstruksioni (në fazë projektimi)
Lezhë	Stafi punon në ambientet e Ish-ZVRPP	Në gjendje të mire.
Shkodër	Punohet në ambientet e Ish ZVRPP dhe 2 ambiente të marra me qira, në katin e parë të një pallati banimi, totalisht të papërshtatshme për zyra. Kjo ka vështirësuar funksionimin normal të kësaj drejtorie.	Është domosdoshmëri sistemimi i punonjësve në ambient tjetër të përshtatshëm shtetëror, dhe në pamundësi të gjetjes së tij, në ambient të marrë me qira
Vlorë	Stafi punonte në godinën e ish ZVRPP në pritje të rikonstruksionit të godinës së kaluar në pronësi	Në proces rikonstruksioni (vijojnë punimet)
Sarandë	Stafi punon në dy godina, njëra e ish ZVRPP dhe tjetra me qira, larg njëra tjetrës dhe që pengojnë funksionimin normal të punës në këtë drejtori.	Është domosdoshmëri sistemimi i punonjësve në ambient tjetër të përshtatshëm shtetëror, dhe në pamundësi të gjetjes së tij, në ambient të marrë me qira.

VI. ANKIMET

21. Proceset gjyqësore.

Ky indikator ka për qëllim që, në gjyqet ku ASHK është palë, të tregojë trendin e çështjeve të fituara në raport me numrin e atyre të humbura.


Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Të zhvilluara	949	806	1033	1263	610	472	736	493
Të fituara	497	423	565	671	334	323	554	333
Raporti në %	52	53	55	53	55	68	75	68



22. Apeli.

Ky indikator ka për qëllim të tregojë trendin e ankimeve administrative ndaj vendimmarrjeve të institucionit.

Viti	(ish ALUIZNI)	(ish ZRPP)	ASHK	TOTAL
2017	123	3.866	-	3.989
2018	251	6.000	-	6.251
2019	212	-	545	757
2020	-	-	1.074	1.074
2021	-	-	1.296	1.296
2022	-	-	-	1.844



Koment: Rritja e numrit të apeliave flet për ndërgjegjësimin e qytetarëve për të kaluar përmes kësaj hallke, që në shumë raste zgjidh problematika ekzistuese, duke shmangur kështu trajtimin gjyqësor.


23. Portali i Bashkëqeverisjes.

Portali “**Shqipëria që duam**” është një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi, e cila ofron një mënyrë komunikimi me publikun, më të shpejtë e më efikase se letrat e shkruara me dorë. Portali ofron mundësinë e marrjes së përgjigjes në një kohë prej 10 ditë pune.

Portali ka filluar funksionimin në Nëntor 2017 dhe administrohet nga Zyra e Bashkëqeverisjes, Agjencia për Dialog e Bashkëqeverisje, në Kryeministri.

Ky indikator paraqet trendin e numrit të ankesave të drejtuara në Portalin e Bashkëqeverisjes, sipas viteve për ish-ZRPP, ish-ALUZINI dhe që nga muaji Qershor 2019, për ASHK-në.

ANKESA BASHKËQEVERISJA	
VITI	NR. ANKESA
2018	6.073
2019	10.163
2020	7.182
2021	6.991
2022*	5.000-10.190



**Të dhënat e paraqitura për vitin 2022, janë të dhëna të marra nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje në Kryeministri. Këto të dhëna, do të merren me rezervë sepse nga ASHK dhe DV/ZV të gjitha të dhënat që do të mundësonin përgatitjen e një raporti analitik, janë fshirë gjatë sulmit kibernetik të muajit Korrik 2022. Me rikuperimin e këtyre të dhënave, do të mundësohet një analizë e qartë dhe një raport përfundimtar në lidhje me këtë indikator.*

Nga të dhëna paraprake të mbledhura nga DV rezulton që kjo shifër realisht të jetë rreth 5.000 ankimime.

VII. TË TJERA

PROBLEMATIKAT

24. PROBLEMATIKA TË KONSTATUARA.

Problematikat kanë kryesisht të bëjnë me bashkërendimin institucional në zbatim të Ligjit nr.20/2020 “ Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

Në këtë drejtim, rezulton sa vijon:

- Zgjatja e proceseve gjyqësore të ngritura pranë gjykatave nga prefektët për pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” ka sjelle problematika për vijimin e procedurave të mëtejshme të trajtimit të këtyre pasurive dhe sigurisë juridike të tyre në qarkullimin civil.
- Mungesa e konfirmimit të dokumentacioneve të pronësisë lëshuar nga institucionet kompetente përpara vitit 1997(leje ndërtimi, dokumentacion privatizimi, etj.) ka sjelle pengesa në disa DVASHK, mbi regjistrimin e pasurive të subjekteve në regjistrat kadastral, apo certifikimin e këtyre pasurive.
- Mospërcjellja nga ana e institucioneve të ndryshme e dokumentacionit hartografik, bashkëlidhur akteve për regjistrim apo shqyrtim në ASHK në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” , jo sipas formatit zyrtar të miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020 “ Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, krijon vonesa dhe problematika në pasqyrimin në hartën kadastrale të këtyre akteve/pasurive.
- Mosparaqitja e kërkesave për informacion dhe dokumentacion nga ana e institucioneve të ndryshme në rrugë digjitale, (portalin “ASHK për institucionet”) dhe mospagesa e tarifave për këto shërbime kadastrale prej tyre në përputhje me parashikimet e VKM nr.389, date 13.05.2020 “ Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale”. (duke krijuar detyrime financiare të pashlyera të prapambetura në favor të ASHK).

RISITË



25. Risitë e Vitit 2022.

Përgjatë vitit 2022, në fushën e digjitalizimit, ASHK ka realizuar risitë si vijon:

Nr.	RISIA	STATUSI	EFEKTI
1.	Implementimi i projektit "Digjitalizimi i Kadastrës", Janar 2022-Dhjetor 2023.	Është realizuar dhe implementuar moduli i posaçëm i cili është në përdorim nga QKD. Gjatë fazës së implementimit janë shtuar edhe element të shtuar sigurie ku të gjitha dokumentet i nënshtrohen procesit të firmës digjitale.	Minimizimi i kohës së trajtimit të aplikimeve dhe rritjen e cilësisë në dhënien e shërbimit
2.	Krijimi i protokollit elektronik të komunikimit me qytetarët për legalizimet	Realizuar që prej muajit tetor 2022, ku të gjitha aplikimet i nënshtrohen parimit FIFO.	Uljen e burokracive në trajtimin e aplikimeve gjithashtu dhe uljen e nr. tw ankesave mbi afatet e trajtimeve, e thënë në zhargon, preferenciale
3.	Dhënie përgjigje vetëm nëpërmjet modulit ASHK për Institucione, për të gjitha institucionet.	Realizuar, gjatë vitit 2022 kemi një shtim të përdoruesve në modul ASHK për institucione qasje e cila dedukton një orientim për institucionet dhe për nismën e re në modul mbi të dhënat e pronës publike.	Formalizimi i kërkesave nga entitet publike
4.	Shërbime të përshpejtuara për qytetarët dhe bizneset, sipas një liste të cilësuar.	Realizuar, 15 Nëntor 2022	Rritje e të ardhurave direkte për institucionin, ulje e burokracive në shërbimet me të shpeshta dhe rritje e cilësisë së ofrimit të shërbimit kundrejt qytetareve.
5.	Vendosja e kufizimeve në sistem për radhën e veprimt dhe transparencën e shërbimeve të dhëna për qytetarët.	Realizuar që prej muajit tetor 2022, ku të gjitha aplikimet i nënshtrohen parimit FIFO. Njoftimi nëpërmjet sms dhe mail të personit i cili ka pronësinë mbi pronën për statusin dhe pergj e aplikimit pasi me pare ky njoftim shkonte vetëm në portal dhe tek Aplikanti i cili mund të ishte përfaqësues dhe jo përfitues direkt.	Uljen e nr. të ankesave, rritjen e nivelit të ofrimit të shërbimit kundrejt aplikuesve dhe rritjen e formave të njoftimit për ofrimin e shërbimit
6.	Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i infrastrukturës hardware,	Realizuar, afati përfundimtar i mbylljes së projektit korrik 2023 sipas termave të kontratës	Rritjen e performances së operimit nga përdoruesit në regjistrin kadastral
7.	Përmirësimi, monitorimi, ristrukturimi i network për ASHK.	Realizuar, afati përfundimtar i mbylljes së projektit korrik 2023 sipas termave të kontratës	Rritjen e nivelit të sigurisë së të dhënave, monitorimin e përdoruesve

- **Implementimi i “FIRST IN / FIRST OUT” në shërbimet kadastrale**

Firmosja e protokollit Teknik të Marrëveshjes së Përbashkët ASHK-DHKN për shërbimet kadastrale, në muajin Tetor 2022.

Firmosja e këtij Protokollit teknik bëri funksional marrëdhënien digjitale midis dy institucioneve. Si rezultat, të gjitha operacionet pronësore që kërkojnë praninë e noterit, tashmë kryhen në kohë reale, përmes firmosjeve elektronike të noterëve. Kjo gjë solli shkurtimin në mënyrë drastike të kohës së operacioneve, pasi dokumentacioni pronësor përcillet nga noteri drejt Kadastrës në rrugë elektronike, duke shmangur ecejaket Qytetar – Noter, Noter – Postë, Postë – Kadastër, Kadastër – Postë, Postë – Noter, e plot të tjera, pa shtuar këtu xhiron nëpër Banka për të paguar faturat. Gjithashtu, mundëson pajisjen me shërbimin e kërkuar brenda 48 orëve nga konfirmimi pagesës për aplikimin e kërkuar. Siguria e të gjithë këtij ndërveprimi, garantohet nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (e-albania), duke bërë autentifikimin dhe certifikimin e aplikimeve që shkëmbehen ndërmjet tyre.

8 Llojet e shërbimeve kadastrale të cilat që nga muaji Tetor 2022 ofrohen përmes nënshkrimit elektronik:

1. Regjistrimi i kontratës së shitjes
2. Regjistrimi i kontratës së dhurimit
3. Regjistrimi i deklaratës për heqje dorë nga pronësia
4. Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës për kredi me vlerë deri në 1.000.000 lekë.
5. Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës për kredi me vlerë me vlerë nga 1 milion deri 10 milion lekë.
6. Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës për kredi me vlerë mbi 10 000.000 lekë.
7. Pasqyrim i bashkëpronësisë bashkëshortore në regjistrimet e mëparshme.
8. Regjistrimi i kontratave të shitjes, dhurimit, me rezerve / kusht të pasurisë së paluajtshme.

Këtyre 8 shërbimeve të para, të kësaj liste, sipas tempistikës së parashikuar nga Protokollit, do t'i shtohen njeri pas tjetrit edhe shërbime të tjera në vijim.

26. Synimet për vitin 2023.

Për vitin 2023-2025 në fushën e digjitalizimit ASHK synon:

1. Sigurimin e ndërlidhjes me sistemin e Fiskalizimit për ASHK.

Përmes këtij projekti synohet të realizohet përmbushja e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar dhe aktet nën-ligjore të nxjerra për zbatimin te tij.

Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë të gjitha nevojat e institucioneve në zbatim të legjislacionit aktual.

Procesi i fiskalizimit do të thotë që faturat e lëshuara, do të regjistrohen në Administratën Tatimore.

Fiskalizimi i faturave do të kryhet nëpërmjet shërbimit të fiskalizimit që është përgjegjës për komunikimin e tatimpaguesve me Administratën Tatimore, përpunimin e mesazheve të pranuar nga Administrata Tatimore.

Në momentin e kryerjes së Aplikimit, në sistemin Multifunksional duhet të kryhen zhvillimet e nevojshme në mënyrë që në momentin e gjenerimit të faturës për aplikantin, fatura të regjistrohet drejt në Administratën Tatimore. Duke qenë se jodomosdoshmërisht faturat e gjeneruara nga ASHK paguhen në momentin e aplikimit për shërbimin e kërkuar, kjo faturë do të regjistrohet si faturë porosi. Çdo faturë e lëshuar në momentin e aplikimit duhet të ketë si metodë pagese të shënuar “porosi” dhe titulli në faturë duhet të jetë “Faturë tatimore/porosi”. Kjo faturë do të fiskalizohet për t’iu referuar më tej gjatë procesit të kryerjes së pagesës nga aplikanti.

Në momentin e kryerjes së pagesës së shërbimit, ASHK do të dërgojë nëpërmjet sistemit Multifunksional një faturë përmbledhëse dhe do ta fiskalizojë atë. Fatura përmbledhëse duhet të përmbajë si referencë dhe të përfshira në të, faturën e mëparshme të lëshuar dhe të fiskalizuar (pra NSLF-në). Vetëm Fatura përmbledhëse e fiskalizuar, do të regjistrohet në librin e shitjeve të tatimpaguesit dhe do të merret në konsideratë. Vetëm në këtë moment, faturat porosi të lidhura me faturën përmbledhëse nuk merren më në konsideratë për llogaritje të qarkullimit. Por, çdo faturë/porosi e veçantë dhe fatura përmbledhëse duhet detyrimisht të fiskalizohen në momentin e lëshimit.

Zgjidhja veç të tjerash duhet të ofrojë dhe:

- Informacion të shpejtë mbi veprimtarinë e secilës Drejtori Vendore.
- Raporte përmbledhëse për të gjithë institucionin.
- Monitorimin e veprimeve të regjistruara nga Drejtoritë Vendore.
- Dashbordin me raportet në formë grafike dhe raporte statistikore.

2. Ngritjen e monitorimit te riskut.

Ky projekt synon ndërtimin e një sistemi elektronik inteligjent i cili do të ketë si funksion studimin e sjelljes së përdoruesve në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme dhe identifikimin e rasteve korruptive. Në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë të njohura veprimet që çojnë në tjetërsim të pronës dhe akses të paautorizuar në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme. Ky sistem do të ketë në përbërje të tij një listë të paracaktuar të veprimeve të paligjshme që mund të kryhen

me pronat dhe pronarët, dhe do të mund të kryejë analiza të hollësishme të veprimeve të përdoruesve që kanë akses në këtë informacion.

Në varësi të sjelljes, sistemi do të dërgojë push notification në strukturat përkatëse. Strukturat në vetvete, nuk do të kenë mundësi të ndryshojnë statusin e alertimit por vetëm të vendosin koment justifikues. Kushdo që të vijë më pas në atë strukturë apo një specialist tjetër auditi, do të ketë mundësi të monitorojë sjelljen e përdoruesit gjatë gjithë kohës që ai është përdorues sistemi si dhe evolucionin e riskut të korrupsionit.

Në këtë mënyrë, mund të menaxhohet fare mirë ligjshmëria e veprimeve mbi pronat të kryera nga nëpunësit e Zyrave të Kadastrës, duke ulur kështu ndjeshëm korrupsionin. Sistemi do të monitorojë veprimet e përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm në regjistrin e pronave, përfshirë këtu dhe ndërveprimet me sistemet e tjera.

3. Ngritjen e Sistemit “e-prona”

Duke qenë se saktësia e informacionit pranë ASHK mbetet ende një problematikë e pazgjidhur, sistemi e-prona do të shërbejë si një mjet, nëpërmjet të cilit pronarët do mund të vetdeklarojnë të dhënat e pronës së tyre.

Për çdo dokument që del nga ASHK në ditë, menjëherë pasi firmoset dokumenti me firmë elektronike nga titullari, të gjitha transaksionet e kësaj prone ruhen në një bazë të të dhënave me teknologji blockchain për të bërë të pamundur ndërhyrjen në çfarëdo formë në transaksione. Duke qenë se në rang Shqipërie kemi rreth 2500 aplikime në ditë, do të rregullonim në mënyrë të përhershme dhe të pakundërshtueshme 650.000 prona në vit. Këto prona do të ishin prona ku ka më shumë transaksione. Këtu duhet një mini ndërhyrje ligjore, ku të detyrohet ASHK që edhe nëse qytetari kërkon vetëm një kopje karteles, ASHK të detyrohet të digjitalizojë edhe hartën nga sistemi dhe në këtë mënyrë ka digjitalizuar në mënyrë të sigurt një pronë që ka interes, shitet, blihet, ndërtohet apo jepet me qera.

Pra qytetari aplikon, nëse prona është e konfirmuar (konfirmuar të paktën një herë me firme e vulë digjitale pasi është implementuar teknologjia blockchain), atëherë ai e merr titullin e pronësisë në mënyrë të menjëhershme në shërbim nivel 4 në e-albania. Nëse prona është e regjistruar por jo e certifikuar, atëherë specialistët e ASHK, do të kryejnë procedurat rutine (ato që kryejnë sot), për t'i kthyer përgjigje qytetarit dhe konfirmuar pronën në këtë mënyrë. Nëse prona për të cilën aplikon qytetari nuk është fare në sistem, atëherë qytetari do të ngarkojë në sistem të gjithë dokumentet që disponon si dhe një genplan për të kryer kështu një regjistrim fillestar sporadik. ASHK, nëpërmjet SQDNE apo regjistrave që ajo disponon, do të verifikojë vërtetësinë e institucionit, do të regjistrojë pronën sipas procedurave standarde dhe do ta arkivojë pronën me dokumentacion, transaksione, gjeneralitete dhe të dhëna hartografike në sistem. Në këtë moment, të dhënat e pronës mund të jenë të disponueshme menjëherë në sistem shërbim nivel 4 në portalin e-albania.

Një nga pikat kyçe të sistemit është menaxhimi. ASHK do të duhet të ketë disa qendra të mëdhaja perpunimi, ku çdo aplikim, menaxhohet nga sistemi me load balancing dhe i bie në mënyrë rastësore një specialist dhe ky i fundit do të duhet të kryejë procedurat përkatëse. Specialistët e tjerë, nuk duhet të dinë kush menaxhon çfarë, pra edhe nëse dikush do të donte të kryente një akt korruptiv, do të detyrohej të kapte të gjithë specialistet e ASHK, që banojnë ndoshta edhe në një qytet tjetër, për të përshpejtuar apo favorizuar procedurën.

4. Sistemin elektronik të arkivës elektronike me teknologjinë blockchain.

Çdo transaksion në sistem bazohet nga dokumentet e origjinës, të cilët janë të pasqyruar në arkiv. Shumica e ndërhyrjeve dhe manipulimeve në lidhje me pronën, kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me ndërhyrjen në arkivën digjitale. Ndërhyrjet mund të bëhen drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave ose përmes sistemeve. Kalimi i arkivës në teknologjinë blockchain do të garantojë përfundimisht vulosjen digjitale tashmë jo vetëm të regjistrit të pronave por edhe të dokumenteve të arkivës digjitale (origjinën e pronës).

5. Arkivimin e regjistrave përfitues të pronësisë me blockchain në prefektura/bashki.

Arkivimi i dokumentacionit, i quajtur gjithashtu arkiva e referencave të pronës, është domosdoshmëri. Nga këto referenca lind çdo transaksion në pronë dhe ndërhyrja në këto referenca bëhet shkak për tjetërsimin e pronave.

Çdo bashki, komune apo prefekturë, ka një regjistër ku ka pas regjistruar AMTP apo aktet e ndryshme për dhurimin e pronësisë. Ky projekt konsiston në skanimin dhe referencimin e gjithë këtyre dokumenteve. Nëse do të skanonim apo referencionim, do të kishim të gjithë dokumentacionin e digjitalizuar, dhe në këtë mënyrë nuk do të kishim më nevojë që ASHK të kërkonte verifikim dokumentacioni nga këto institucione dhe të shtonte mundësitë për korrupsion.